



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM
Nr 116 Datë 11.12.2009

Për miratimin e fondit prej 300 000 Lekësh për realizimin e dokumentarit televiziv për prezantimin e qytetit

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit si dhe drejtoria e Marredhënieve me Publikun "Për miratimin e fondit prej 300 000 Lekësh për realizimin e dokumentarit televiziv për prezantimin e qytetit, në zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, në ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në ligjin nr 1025 dt. 27.11.2008, "Për buxhetin e vitit 2009", në Udhëzimin e MF nr 2 dt. 12.01.2009 «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009» në VKB nr 12 dt 13.02.2009 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009», mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë fondin prej 300 000 lekësh nga fondi rezerve i Bashkisë tek Sirea Film dhe DigitAlb për realizimin e dokumentarit televiziv për prezantimin e qytetit sipas kesaj strukture buxhetore

Pakesohet	00	04980	05 Art 609 0000 - 300 000
Shtohet	00	01110	05 Art 604 4005 + 300 000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit, Drejtoria e Marredhënieve me publikun, Drejtoria Juridike si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gjergji PENDAVINJI